



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 882/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

**V E N D I M**

- I. Rikreditohen/Akreditohen programet e studimeve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  1. *Menaxhment, BSc 180, me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
  2. *Menaxhment, MSc 120, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
  3. *Marketing, MSC 120, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshime të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim/ Riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Management, BSc 180	Gentrit Berisha Albana Berisha Qehaja Veton Zeqiraj
2.	Management, MSC 120	Besnik Krasniqi Lura Rexhepi
3.	Marketing, MSC 120	Visar Rustemi Vjosa Fejza Ademi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Menaxhment BSc 180, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis, Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) ndërsa Pjesërisht dy (2) fusha.
2. Për programin e studimit; Menaxhment, MSc 120, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis, Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) ndërsa Pjesërisht dy (2) fusha.
3. Për programin e studimit; Marketing, MSC 120, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis dhe Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht katër (4), ndërsa Pjesërisht tre (3) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

